



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I BASHKISË**  
**KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK**

Nr.8301 Prot.  
12.2

Patos, më 20/04/2022

**PROCES-VERBAL**

I mbajtur sot në datë 19.04.2022 ora 10:00 në ambientet e Njësisë Administrative Ruzhdie organizohet takimi konsultativ me përfaqësues të shoqërisë civile dhe grupe interesit lidhur mbi marrjen e kërkesave prioritare për hartimin e "PBA-2023-2025"  
Pjesëmarrës në këtë mbledhje janë:

1. Përfaqësues të Këshillit Bashkiak
2. Kryetarë të fshatrave
3. Fermerë të zonës
4. Përfaqësues të ekzekutivit të Bashkisë

Takimi hapet nga Këshilltari Ervis Rucaj

**Ervis Rucaj** – unë ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim konsultativ me banorët e zonës tuaj lidhur mbi priorititetet tuaja për buxhetin afatmesëm, prandaj kërkojmë mendimin tuaj se ku Bashkia mund t'i adresojë fondet për shërbime, investime apo dhe funksione të tjera të cilat Bashkia i ka detyrim. Për këtë qëllim ne kërkojmë të marrim sa më shumë informacione përmes këtyre takimeve me qëllim vjeljen e mendimit tuaj për përdorimin e fondeve publike nga ana e Bashkisë, ofrimit të shërbimeve prej saj si dhe cilat janë funksionet të cilat konsiderohen prioritare për komunitetin. Ndaj presim opinionin tuaj se si janë realizuar fondet dhe ku mund t'i përdorim në të ardhmen. Fjala është për ju.

**Balil Balili** – që ne të mos përsërisim veten në kërkesat që do të parashtroni specialisti i financës do tju prezntoj të gjitha investimet që janë prarashikuara nga bashkia për t'u investuar në zonën tuaj gjatë këtij viti kalendarik dhe më pas le të vazhdojmë me marjen e kërkesave.

**Andi Kola** ( Sp.Finance )- prezanton investimet e parashikuara për tu investuar në Njësinë Administrative Ruzhdie për vitin 2022.

Haxhi Qosanj ( Kryetar i fshatit Kasnicë) – unë e kuptoj që bashkia bën një punë voluminoze por unë kam disa kërkesa për fshatin Kasnicë: së pari kërkoj me forcë vendosjen e një gabine elektrike pasi mjafton të fryjë erë dhe i gjithë fshati mbetet në errësirë; - kérkojmë të ndërhyet për hapjen e rrugëve për në parcelat bujqësore si dhe shtrimin e atyre ekzistuese; - rruga hyrëse për në fshat segmenti “Oficinë –Kasnicë” është e dëmtuar plotësisht edhe pse nga bashkia është ndërhyrë për shtrimin e saj me rërë bituminoze prap është e pakalueshtme dhe e dëmtuar ndaj kérkoj që ky segment rrugor të projektohet për tu investuar me asfalto beton dhe kjo është një kérkesë e përsëritur edhe më parë por nuk është marrë parasysh nga bashkia. Gjithashtu një shqetësim tjetër që kam si kryetar i fshatit është fakti se ne kemi shumë pak tokë për frysë të përfituar nga ligji 7501 dhe shumë familje jetojnë me pagesën e ndihmës ekonomike e cila është e pamjaftueshme dhe kérkoj që banorët të marrin më shumë tokë.

Riza Mema – ju bëtë mirë që na treguat investimet për vitin 2022, por duhet të keni parasysh që ne si fshat kérkojmë ujë të pijshëm gjithashtu edhe rrugë.

Balil Balili – lidhur mbi problemin e tokë ku ju ngrini pretendimin e kuatës së ulët për frysë dua tu them se kjo nuk zgjidhet nga ne si Bashki ndërsa lidhur mbi përkrahjen sociale është e drejta e cdo familje të aplikoj në skemën e ndihmës ekonomike për të qenë përfitues i kësaj skeme.

Myftar Soraj (Kryetar i fshatit Siqecë) – nga eksperiencia e viteve të kaluara ne kemi bërë dëgjesa ku janë marrë parasysh problemet në fshatrat tonë cilat disa jo në buxhet, pasi kjo padishim varet dhe nga buxheti që i vjen Bashkisë. Lidhur mbi fshatin Siqesë unë dua të ngre disa cështje të cilat në gjykimin tim janë tepër madhore. Problemi kryesor është mospasja e ujit të pijshëm në lagjen “Xhepaj”; - lagjja Xhepaj ka shumë probleme me rrugët e saj dhe kérkoj që të parashikohet investimi i rrugëve të fshatit; - ne jemi fermerë dhe jetojmë vetëm me të arhurat e fituara nga toka, por problemi që e kam ngritur dhe herë të tjera është problemi i azhorimit të tokës dhe mos pasja e certifikatës së pronësisë; - kérkoj që të ndërhyet për shtrimin dhe hapjen e rrugëve të reja për në parcelat e tokave bujqësore.

Balil Balili – mesa kuptoj kérkesat e përsëritura janë ato për rrugët e parcelave të cilat ne i mbajtëm shënim dhe padishim në gjykimin tim ekzekutivi do parashikoj fond për mirëmbajtjen ose hapjen e rrugëve të parcelave, ndërsa lidhur me azhornimin e tokës ashtu sic dhe e dini ky është një proces që nuk bëhet nga Bashkia, por nga hipoteka gjithsesi ne do ta cojmë fjalën tonë deri në qeveri që procesi i azhornimit të shtrihet edhe në njësinë Ruzhdie.

Nuri Gllava (Kryetar i fshatit Gjynoqar) – për fshatin Gjynoqar kérkoj që në buxhetin e vitit 3-vjectar të parashikohen këto investime: rikonstruktion të rrugëve të brendshme të fshatit; - rikonstruksion të rrugëve të parcelave; - kérkojmë vendosje të koshave të pehrave në fshat; - për subvencioimin e naftës ne si fermerë nuk kemi përfituar nga aplikimet e bëra në skemat kombëtare mbeshtetëse përfituar; -

Ervis Rucaj – lidhur mbi skemat përfituese për ju fermerë pikë së pari duhet të aplikoi në projekte të tilla për të dalë fitues më pas ndërsa lidur mbi skemën mbështetëse për fermerët për kompesimin e naftës kjo nuk është një skemë mështetëse e qeverisë.

Nuri Gllava – unë kam aplikuar dhe nuk na është dhënë asnjë përgjigje. Gjithashtu duhet të vë theksin te rritja e cmimeve të shportës.

Agim Mesuti (Administrator i Njësisë Ruzhdie) – jam dakord me kërkesat dhe shqetësimet e ngritura deri tani të cilat padyshim qëndrojnë dhe janë të drejta. Unë dua të therksoj edhe njëkherë problemet kryesore të njësisë të cilat kanë të bëjnë me; hapjen e rrugëve të parcelave, problemi i ujit të pijshëm në të gjithë njësinë, por që sigurisht jemi në pritje të fillimit të punimeve për lotin e dytë të projektit të Ujësjellësit i8 cili do të zgjidhi njëherë e mirë problemin e ujit të pijshëm në njësi. Kërkoj të investohet në rrugët në mes të fshatrave për shtrimin dhe zgjerimin e tyre ku dua të theksoj se rruga e fshatit Gjynoqar deri në Manxharaj kërkon investim urgjent.

Ervis Rucaj - ndonjë kërkesë tjetër për njësinë ose fshatin tuaj? M.q.se. jo ju falenderoj për kohën që na kushtuat për të diskutuar së bashku mbi problemet e zonës tuaj të banimit.

Kjo është faza e parë për hartimin e buxhetit 3-vjecar dhe ne do të takohemi përsëri në konsultime të tjera, ndaj edhe një herë dua t'ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj

**Koordinator  
Për Konsultimin Publik  
Suzana Hysenaj**

